


Bibël për fëmijët  
paraqet

## Samaritani i Mirë



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: M. Maillot; Lazarus

Adaptuar nga: Ruth Klassen; Sarah S.

Alastair Paterson

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi

Prodhuar nga: Bible for Children

[www.M1914.org](http://www.M1914.org)

©2020 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori,  
nëse nuk do ta shitni.



"Mësues! Çfarë duhet të bëj unë, që të marr jetën e përjetshme?"



Njeriu që bëri këtë pyetje ishte një njeri i ligjit, duke u përpjekur ta mashtrojë Jezusin. "çfarë thotë ligji i Perëndisë"? iu përgjigj Jezusi.




“Duaj Perëndinë  
dhe të afërmin tënd”,  
tha burri. “Por, kush  
është i afërmi im”?




Për t'ju përgjigjur pyetjes, Jezusi tregoi një histori, për një njeri që po udhëtonte nga Jerusalemi në Jeriko. Ky njeri u sulmua nga hajdutët.



Hajdutët i vodhën gjithçka, madje  
i morën edhe rrobat udhëtarit të  
shkretë.



Ata e palgosën shumë keq, duke  
e lënë gjysëm të vdekur anës  
rrugës.





Tani, ndodhi që një prift kaloi aty pranë. Me siguri ai do ta ndihmojë njeriun e plagosur.



Jo! Kur ai pa njeriun e  
gjakosur, kaloi nga ana  
tjetër e rrugës.



Shpejt, një zhurmë hapash tregoi se një njeri tjetër po afrohej. Ai ishte një Levit - një njeri që ndihmonte priftërinjtë në tempull.



Kur u afrua, ai e pa njeriun e plagosur,  
por vazhdoi rrugën e tij pa e ndihmuar.



Më në fund, një Samaritan kaloi andej.  
Judenjtë i urrejnë Samaritanët.




Njerëzit që po dëgjonin historinë e Jezusit,  
nuk e prisnin që një Samaritan të ishte  
heroi. Por, ai ishte. Samaritanit i  
erdhi keq, dhe ndaloj ta ndihmojë.



Samaritani u përku! dhe me butësi vendosi ilaç dhe fashoi plagët e të huajit. Pastaj, ai e ndihmoi njeriun e plagosur duke e hypur mbi gomarin e tij.



Në një han buzë rruge, Samaritani  
u kujdes gjithë natën për atë njeri.





Në mëngjes, ai pagoi të zotin e hanit  
që të kujdesej për udhëtarin derisa  
të bëhej mirë.



Historia mbaroi. Jezusi pyeti, "Kush ishte i afërmi i njeriut të plagosur"?





Mësuesi i ligjit u  
përgjigj, "I afërmi i  
tij ishte Samaritani  
që tregoi mëshirë".



“Shko, dhe bëj po ashtu edhe ti”, tha Jezusi. I afërmi ynë është kushdo që ndodhet në nevojë. Ne mund të tregojmë dashuri duke ndihmuar njerëzit në nevojë. Kjo i pëlqen Perëndisë.



# Samaritani i Mirë

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Llukes 10

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u  
jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130



Fund



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të  
mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që  
ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan  
mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve  
aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në  
Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall  
dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij  
të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëjë atë! Ai do të vijë dhe do të  
jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.

Nëse ti beson se kjo është e vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:  
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i bërë njeri për të  
vdekur për mëkatet e mia, dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem,  
eja në jetën time dhe fali mëkatet e mia, në mënyrë që unë të kem  
jetë të re dhe një ditë të jem me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo,  
të të bindem dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë çdo ditë! Gjoni 3:16

